Sportistët në pension në pritje te kryetari i Shoqatës

Pensionistët-sportistë struganë që morën pjesë në garat sportive kombëtare që u zhvilluan në Shkup, shënuan histori. Ata garuan në disa disiplina në mesin e konkurrencës së fortë të 43 Shoqatave të Pensionistëve nga Republika dhe fituan dy vendet e para në koshin e gjuajtjes së lirë për meshkuj, të përbërë nga Jovan Jovanoski, Ferid Abdul dhe Stefan Golaboski dhe ekipi i grave që garoi në penallti në gola të vegjël të përbërë nga Marija Gjura, Violeta Opetçeska dhe Elena Mlladenoska, të cilat u dekoruan me medalje ari.

Me atë rast, kryetari i SHP Struga, Millorad Trposki, organizoi pritje për ta dhe kryetarin e Komisionit për sport, Jovan Poposki, në hapësirat e shoqatës, për angazhimin e garave të sivjetme. Kryetari Trposki i falënderoi ata personalisht dhe individualisht për mundin e bërë. Ai u uroi atyre jetë të gjatë e të shëndetshme dhe shumë vite që të garojnë dhe të sjellin fitore për veten dhe shoqatën. Me vendim të Bordit Ekzekutiv, sportistëve iu dhanë një palë tuta.

(S. Kukuneshoski)

TAKIMI MULTIETNIK ME ATMOSFERË BRILANTE

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të 20 Shoqatave të pensionistëve nga mbarë vendi, afër 410 pjesëmarrës, përfshirë edhe përfaqësuesit e LSHPM në krye me Kryetaren, Stanka Trajkova

Më 20 tetor të vitit 2024, për të 26-tën herë në Tetovë u mbajt takimi tradicional multietnik i pensionistëve të Maqedonisë. Restoranti "Teteks-Arena" ishte vendtakimi i pensionistëve, të cilët nën tingujt muzikor të grupeve muzikore "Maestro Bend" nga Tetova dhe "Do Re Mi" nga Gostivari, në gjuhën maqedonase dhe shqipe, në atmosferë madhështore, pensionistët nga mbarë vendi kaluan çaste që do të mbeten në kujtesë një kohë të gjatë. Në këtë takim ishin të ftuar për pjesëmarrje dhe morën pjesë 20 përfaqësues të Shoqatave të pensionistëve, përfshirë Lidhjen e Shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë në krye me kryetaren Stanka Trajkova, Kryetari i komunës së Tetovës, Bilall Kasami si dhe anëtar të Këshillit ekzekutiv të SHP Tetovë dhe pensionistë të tjerë nga qyteti nikoqir.

Fillimisht pensionistëve në këtë takim iu drejtua Kryetari i Kuvendit të SHP Tetovë, Mirko Jovçevski, Kryetari i Këshillit ekzekutiv dhe kryetar i Shoqatës, Selver Memeti, Kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova dhe Kryetari i komunës së Tetovës, Bilall Kasami.

Dy udhëheqësit e SHP-Tetovë Jovçevski dhe Memeti gjatë përshëndetjes drejtuar të pranishmëve, midis tjerash deklaruan se për Tetovën është kënaqësi të zhvillohet një takim i kësaj natyre dhe me përmasa siç është ky i sotmi, ku në një vend janë grumbulluar pensionistë nga më shumë qytete të vendit. Në këtë drejtim, Shoqata e pensionistëve të Tetovës, ndjenë kënaqësi të veçantë kur sheh në një vend numër kaq të madh të pensionistëve, të cilët mes vete realizojnë kontakte, shkëmbim mendimesh, njohje të ndërsjella, etj., deklaruan udhëheqësit e SHP-Tetovë.

Kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova, duke iu drejtuar pensionistëve pjesëmarrës në këtë takim multietnik, veçoi SHP-Tetovë si organizatore e shkëlqyeshme e takimeve të kësaj natyre. Shoqata e pensionistëve të Tetovës ka një traditë të gjatë të organizimit të takimeve të këtilla, çdo segment i organizimit është përpunuar me përpikëri dhe s'ka mundësi të ketë lëshime në organizimin dhe mbajtjen e këtij takimi apo takimeve të tjera me pensionistë, nënvizoi Trajkova. Ajo me këtë rast veçoi praninë e Kryetarit të komunës së Tetovës, Bilall Kasami, pjesëmarrja e të dëshmon për mbështetjen që kanë pensionistët nga vetëqeverisja lokale e komunës së Tetovës, deklaroi Trajkova.

Kryetari i komunës së Tetovës, Bilall Kasami në fjalën e tij përshëndetëse, përgëzoi pensionistët nga mbarë vendi për aktivitetet që i zhvillojnë për të mirën e moshave të treta. Kasami përmendi rritjen lineare të pensioneve, duke u zotuar se ky trend i rritjes së pensioneve do të vazhdojë edhe gjatë viteve në vijim. Komuna e Tetovës do t'i mbështes pensionistët në zhvillimin e Programeve të tyre, ndërsa dyert e institucionit që e udhëheq gjithmonë do të jenë të hapura për pensionistët, nënvizoi kryetari Bilall Kasami. Bazuar në deklaratat e pjesëmarrësve të këtij takimi multietnik të pensionistëve, mund të konkludohet se i njëjti është organizuar dhe realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Madje kishte mendime sipas të cilëve, ky manifestim kësaj radhe ishte i nivelit të lartë si asnjëherë më parë.

(M. Murseli)

Momente të paharrueshme në Gostivar

Më 23 dhe 24 shtator të këtij viti u mbajt seanca me aktivin e grave pensioniste, anëtare të Trupit koordinues të pensionisteve në LSHPM, ndërsa nikoqir ishte SHP Gostivar, në të cilën u realizuan një pjesë e Programit Vjetor dhe aktiviteteve të përbashkëta me asetet në një mjedis multietnik. Të pranishëm përveç anëtarëve të Trupit koordinues ishin edhe kryetaret e aktiveve nga të gjitha rajonet. Kryetari i SHP Gostivar, Niazi Xhelili u shpreh i kënaqur që janë nikoqirë të seancës së Trupit koordinues të pensionisteve të LSHPM. Ai foli për aktivitetet e shoqatës si shoqatë multietnike në të cilën funksionojnë 23 degë që bashkëpunojnë me sukses njëra me tjetrën.

Një nga pensionistet më aktive në SHP Gostivar, Vadije Zendeli u tregua një nikoqire e vërtetë dhe një organizatore e shkëlqyer. Ditën e parë, gjatë vizitës së qytetit, ata vizituan kishën "Sveta Bogorodica" dhe Xhaminë e Sahatit në Gostivar.

Në ditën e dytë u shkëmbyen përvoja me një demonstrim të disa produkteve. U përgatitën edhe specialitete nga të gjitha anët e Maqedonisë. Në fund të shoqërimit, aktivistët e pranishëm falënderuan kryetaren e Aktivit të pensionisteve të SHP Gostivar, Vadije Zendeli, e cila u mundësoi atyre momente të paharrueshme, si dhe kryetarin Xhelili për mbështetjen e dhënë. Takimi dëshmoi se sa i suksesshëm mund të jetë bashkëpunimi me organizim të mirë dhe dëshirë të mirë. (Maria Monevska)

PËR NDER TË ÇLIRIMIT TË SHKUPIT

U mbajt turneu tradicional në shah

Pensionistët e Shkupit, dashamirës të lojës së shahut, shënuan siç duhet 13 Nëntorin e këtij viti me rastin e 80 vjetorit të Shkupit të lirë. Në Shtëpinë e ARM-së për herë të 22-të u mbajt turneu tradicional në organizim të Lidhjes së shoqatave të qytetit të Shkupit. Në këtë takim festiv të shahut morën pjesë shahistët nga shoqatat Pensionistët e luftës, Ilinden, Kisella Vodë, Aerodrom Solidarnost, Taftalixhe, Çair, Shuto Orizarë dhe Butel. Edhe shahistët nga Aerodrom Solidarnost dhe Qendër demonstruan njohuritë e tyre për këtë lojë.

Turneun, me fjalën e duhur, e hapi Tomislav Taftabitoski, kryetar i Lidhjes së shoqatave të qytetit, i cili në emër të pjesëmarrësve dhe në emër të tij dërgoi urime me rastin e 13 Nëntorit, duke theksuar se gjeneratat e sotme me të drejtë krenohen me çlirimtarët e qytetit, por edhe se kanë borxh të kujdesen për zbukurimin e vazhdueshëm të tij dhe për një jetë më të mirë të qytetarëve. Më pas ai ftoi poetin Pero Milenkoski, anëtar i ekipit nga Taftalixhe, të përshëndesë të pranishmit me këngën Shaholjubie.

Turneu i sivjetshëm, ku mori pjesë edhe kryetari i Lidhjes së Shahut të Qytetit të Shkupit, Gjorgji Minovski, kaloi në një atmosferë të qetë, por luftarake. Dyzet pjesëmarrësit paraqitën edhe një herë lidhjen e tyre me lojën e lashtë. Në fund në konkurrencën e meshkujve fitues dolën shahistët e Qendrës, vendin e dytë e fituan lojtarët e Solidarnost Aerodrom, ndërsa vendin e tretë e fituan shahistët nga Çairi. Në konkurrencën e femrave më të suksesshme rezultuan pensionistet e Solidarnost Aerodrom, të cilët fituan vendin e parë. Shoqërimi i përvitshëm i shahut u mbyll me një drekë urimi e ndjekur nga këngë e lojëra. *(P.Milenkoski)*